L I G J
Nr.9599, datë 27.7.2006

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8981, DATË 12.12.2002 "PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pas nenit 1/3 të ligjit nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar, shtohet neni 1/4 me këtë përmbajtje.

"Neni 1/4

Reduktohen në 0 për qind tarifat doganore për disa nga kodet doganore të kapitujve 84, 85 e 87 të nomenklaturës së mallrave, sipas aneksit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5019, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu